



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosova

KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1 dhe 4, nenit 19, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 dhe nenit 48 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr. 04/L-150, në mbledhjen e mbajtur me xxxxxxxx, miraton:

STATUTIN E ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS
(Tekst i spastruar me plotësim ndryshimet e miratuar nga Kuvendi i OSK-së më datën

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Oda e Stomatologëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda) është organizatë e pavarur profesionale e stomatologëve që ushtrojnë veprimtari profesionale mjekësore/stomatologjike në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Oda mbron dhe përfaqëson interesat profesionale të anëtarëve të saj, siguron standardet e larta të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike, promovon dhe mbron veprimtarinë e stomatologëve në institucionet shëndetësore publike dhe private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional në bashkëpunim me institucionet relevante arsimore dhe organizatat profesionale me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve stomatologjike.

Neni 3

Me këtë Statut rregullohen emërtimi, selia dhe organizimi i brendshëm, anëtarësia, kompetencat, organizimi dhe funksionimi, mbajtja e regjistrit të anëtarëve, organet e Odës, mënyra e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve, përbërja dhe kompetencat e organeve, përgjegjësia disiplinore e anëtarëve, procedurat para Këshillit Etik dhe Gjyqit të Nderit, burimet e financimit dhe çështje të tjera me rëndësi për punën dhe funksionimin e Odës.

Neni 4

1. Oda ka statusin e personit juridik me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë të paparpara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe me këtë Statut.
2. Oda vepron në emër të vet dhe do të jetë përgjegjëse për detyrimet dhe obligimet e saj, përfshirë këtu të gjitha resurset me të cilat disponon.

Neni 5

1. Emri i Odës është Oda e Stomatologëve të Kosovës. Shkurtesa e emrit është OSK
2. Emri i Odës-së në gjuhën angleze është Dental Chamber of Kosova
3. Emri i Odës-së në gjuhën serbe është Stomatološka Komora Kosova
4. Selia e Odës është në Prishtinë.

Neni 6

1. Oda ka simbolin e vet zyrtar, dhe gëzon mbrojtje ligjore.
2. Në të është vizatuar hyrja në një tempull i cili mbështetet në tre shtylla, ku në gjuhën latine shkruan: *Educatio, Ethica dhe Humanitas*. Në hyrje të tempullit janë tre shkallë të cilat simbolizojnë tre nivelet e sistemit shëndetësor në Republikën e Kosovës. Ngjyra e kornizës dhe e vizatimit është ngjyra e arit dhe shkronjat e tekstit janë me ngjyrë të zezë, prapavija është e bardhë.

Neni 7

1. Oda e ka vulën e vet të rrumbullakët dhe katrore.
2. Përmbajtja, mënyra e përdorimit dhe ruajtjes së vulës të rrumbullakët dhe asaj katrore rregullohet me akt të veçantë të Odës.

Neni 8

1. Odën e përfaqëson Kryetari dhe vepron në emër të saj.
2. Në mungesë të Kryetarit, Odën e përfaqëson njëri nga Zëvendëskryetarët e saj.

KREU II

ANËTARËT E ODËS

Neni 9

Anëtarësimi në Odë

1. Anëtarësimi në Odë është i detyrueshëm për të gjithë stomatologët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës.
2. Anëtarësimi në Odë është i detyrueshëm edhe për stomatologët të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kushte të mbrojtjes sociale, në institucionet e organeve shtetërore, në fakultete ose shkolla profesionale, në ambulanca të mjekësisë së punës si dhe në të gjitha rrethanat tjera ku ushtrohet veprimtaria shëndetësore në përputhje me ligjet në fuqi.
3. Shtetasit e huaj, për ushtrimin e profesionit të stomatologut në Republikën e Kosovës, janë të detyruar të anëtarësohen paraprakisht në Odë, të njohin dhe të zbatojnë Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike, si dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë shërbimin shëndetësor në Republikën e Kosovës.
4. Statusi i anëtarit fitohet me regjistrimin në regjistrin qendror të Odës.
5. Anëtarësia në Odë përfundon në ditën e fshirjes nga Regjistri i Anëtarëve.

Neni 10

Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve

1. Në realizimin e kompetencave dhe detyrave, anëtarët kanë këto të drejta:
 - 1.1. Të ushtrojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar;
 - 1.2. Të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e Odës;
 - 1.3. Të japin propozime dhe iniciativa për çështje aktuale në fushën e stomatologjisë pranë organeve të Odës;
 - 1.4. Të informohen për të gjitha çështjet e punës dhe afarizmit të Odës përmes faqes zyrtare të saj ose formave tjera elektronike;
 - 1.5. Drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesve të tyre të japin propozime dhe shprehin mendimin për mbrojtjen e interesave dhe integritetit personal e të përgjithshëm në ushtrimin e veprimtarisë stomatologjike;

- 1.6. Të përfitojnë ndihmë materiale nga fondi i veçantë i solidaritetit të Odës, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parapara me akte të veçanta të Odës;
- 1.7. Të shfrytëzojnë të drejta tjera të parapara me akte të veçanta të Odës.

Neni 11

Obligimet dhe përgjegjësitë

1. Anëtarët janë të detyruar::
 - 1.1 Të respektojnë Statutin dhe Kodin Etik dhe Deonatologjinë Stomatologjike;
 - 1.2 Të paguajnë rregullisht anëtarësinë;
 - 1.3 Të marrin pjesë rregullisht dhe t'i kryejnë obligimet në organet e Odës ku janë zgjedhur;
 - 1.4 Të respektojnë standardet dhe normat profesionale të shërbimit shëndetësor dhe të përfshihen në mënyrë të vazhdueshme në edukimin profesional;
 - 1.5 Të përmbushin obligimet dhe përgjegjësit e tjera të parapara me akte normative të Odës.

Neni 12

Ndërprerja e anëtarësimit

1. Anëtarësimi në Odë ndërpritet në këto raste:
 - 1.1 Me tërheqjen e përhershme të licencës;
 - 1.2 Me kërkesë të anëtarit, nga dita e marrjes së vendimit nga organi kompetent i Odës për çregjistrim nga Regjistri i Anëtarëve;
 - 1.3 Në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, sipas vendimit të formës së prerë gjyqësore;
 - 1.4 Në rast të mospagesës së anëtarësisë për gjashtë (6) muaj rresht;
 - 1.5 Në rast të vdekjes së anëtarit.
2. Anëtari të cilit i është ndërprerë anëtarësia është i detyruar që, brenda 7 ditësh, t'ia dorëzojë Odës kartelën e anëtarësimit; në të kundërtën, Oda e paraqet rastin në Këshillin Etik për fillimin e procedurës për shkelje të legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Rianëtarësimi

1. Anëtarët të cilët i është ndërprerë anëtarësimi kanë të drejtë aplikimi për rianëtarësim në këto raste:
 - 1.1 Në të gjitha rastet kur ndërprerja e anëtarësisë është bërë me kërkesën e vetë anëtarit;
 - 1.2 Në rastin e rikthimit të zotësisë së veprimit sipas vendimit gjyqësor;
 - 1.3 Në rast të përmbushjes së obligimeve të anëtarësimit për të cilat është shqiptuar masa e taksës administrative për rianëtarësim.
2. Procedura e rianëtarësimi rregullohet me aktë të vecantë të Odës.

Neni 14

Regjistrat e profesionistëve shëndetësorë

1. Oda në pajtim me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë mbajn këto regjistra:
 - 1.1 Regjistri i të gjithë anëtarëve të Odës;
 - 1.2 Regjistri i licencave të lëshuara dhe të revokuara;
 - 1.3 Regjistri i masave disiplinore të shqiptuara anëtarëve të saj.

Neni 15

1. Organi kompetent i Odës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e paraqitjes të kërkesës nga profesionistët shëndetësorë me vendim lejon regjistrimin në Regjistrin e të gjithë anëtarëve të Odës.
2. Ndaj vendimit të paragrafit 1 të këtij neni mund t'i ushtrohet ankesë organit kompetent brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit.

Neni 16

Anëtarët janë të detyruar që organit kompetent t'i paraqesin çdo ndryshim me rëndësi për regjistrim sipas neni 13 të këtij Statuti, si dhe fakte të tjera të rëndësishme në kompetencë të Odës, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e informimit për ndryshimet përkatëse.

Neni 17

Regjistrat nga neni 13 i këtij Statuti janë dokumente publike.

Neni 18

Oda me akte të veçanta përcakton mënyrën e regjistrimit, evidentimit dhe mirëmbajtjes së regjistrave, përmbajtjen e tyre, si dhe formën e shkresave, vërtetimeve dhe akteve tjera të Odës në bazë të evidencës zyrtare.

KREU III KOMPETENCAT E ODËS

Neni 19 Kompetencat publike

1. Kompetencat publike të Odës janë:

- 1.1. Miratimi i Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike;
- 1.2. Regjistrimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të profesionistëve dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë dhe e të gjitha institucioneve shëndetësore;
- 1.3. Lëshimi i licencave të stomatologëve, rilicencimi dhe revokimi i tyre;
- 1.4. Mbikëqyrja e funksionimit ligjor të institucioneve nga nenet 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për Shëndetësi.
- 1.5. Zbatimi i mbikëqyrjes profesionale me angazhim të eksperteve të lëmive përkatëse;
- 1.6. Bashkëpunimi me organet shtetërore dhe lokale që adresojnë çështjet e shëndetësisë dhe bashkëpunimi me shoqatat e tjera profesionale në vend dhe jashtë vendit;
- 1.7. Ushtrimi i mbikëqyrjes profesionale dhe ligjore për punën e stomatologëve;
- 1.8. Planifikimi dhe zbatimi i edukimit të vazhdueshëm profesional;
- 1.9. Ndërmjetësimi në kontestet ndërmjet anëtarëve të Odës dhe shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore;
- 1.10. Organizimi i Gjyqit të Nderit në lidhje me përcaktimin e shkeljeve dhe obligimeve profesionale të anëtarëve të saj dhe shqiptimi i masave disiplinore;
- 1.11. Caktimi i lartësisë së anëtarësisë për anëtarët e saj;
- 1.12. Caktimi i lartësisë së taksës për licencim, rilicencim dhe lejeve të tjera për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në bazë të autorizimeve ligjore;
- 1.13. Lëshimi i kartelave të identifikimit dhe numrave identifikues për anëtarët e saj;
- 1.14. Lëshimi, me kërkesë të anëtarëve i certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve të tjera mbi evidencën zyrtare të Odës.

Neni 20

Përgjegjësitë publike ushtrohen nga organet e Odës sipas procedurës së paraparë me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 21

Kompetencat e tjera

1. Kompetencat e tjera të Odës janë:

- 1.1. Përfaqëson dhe mbron interesat profesionale të anëtarëve në ushtrimin e profesionit;
- 1.2. Kujdeset për ruajtjen e autoritetit të anëtarëve në ushtrimin e punëve profesionale në pajtim me etikën profesionale;
- 1.3. Mban evidencën e anëtarëve që ushtrojnë veprimtarinë private shëndetësore dhe janë të regjistruar në regjistrin e organit kompetent, në pajtim me ligjin;
- 1.4. Bashkëpunon me organet shtetërore e lokale dhe me shoqatat profesionale në vend dhe jashtë vendit;
- 1.5. Jep mendime profesionale dhe merr pjesë në përgatitjen e ligjeve, dokumenteve si dhe akteve të tjera nënligjore në sektorin e shëndetësisë, si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- 1.6. Propozon dhe inicion nxjerrjen e akteve të përgjithshme dhe të veçanta në përputhje me Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të Odës;
- 1.7. Bashkëpunon me institucionet përgjegjëse në përcaktimin e çmimeve të shërbimeve stomatologjike;
- 1.8. Përpilon programin e edukimit të vazhdueshëm profesional për profesionistët e stomatologjisë;
- 1.9. Ndërmerr aktivitete shkencore dhe hulumtuese në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e Odës;
- 1.10. Përfaqëson interesat profesionale dhe sociale të profesionistëve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve tjerë;
- 1.11. Këshillon, ofron asistencë dhe përfaqëson interesat e anëtarëve në fushën e legjislacionit dhe fushat e tjera të ndërlidhura me shëndetësinë;
- 1.12. Merr pjesë në lidhjen e kontratave me Fondin për Sigurime Shëndetësore;

- 1.13. Themelon dhe menaxhon buxhetin e Odës;
- 1.14. Bashkëpunon me organet kompetente në parandalimin e veprimtarisë shëndetësore ilegale;
- 1.15. Bën botimin e revistave dhe publikime të tjera profesionale (libra, broshura etj)
- 1.16. Promovon bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të saj;
- 1.17. Promovon bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve dhe organizon aktivitete kulturore, sportive dhe ngjarje të tjera sociale;
- 1.18. Emëron përfaqësues të Odës në marrëveshje me institucionet e të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor;
- 1.19. Përmes të deleguarve në komisione, borde dhe grupe punuese qeveritare, jep rekomandime për aktet përkatëse legjislative që nxirren nga ministrinë përgjegjëse;
- 1.20. Zbaton aktivitete të tjera në përputhje me ligjin, Satutin dhe aktet e të përgjithshme të Odës.

KREU IV ORGANET E Odës

Neni 22

1. Organet e Odës janë:
 - 1.1. Kuvendi;
 - 1.2. Kryetari i Odës;
 - 1.3. Këshilli Drejtues;
 - 1.4. Këshilli Mbikëqyrës;
 - 1.5. Këshilli Etik;
 - 1.6. Gjyqi i Nderit;
 - 1.7. Prokurori;
 - 1.8. Komisionet e përhershme.

2. Mandati i anëtarëve të Kuvendit dhe i anëtarëve të organeve të Odës zgjat katër (4) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm edhe një mandat tjetër.
3. Mandati i anëtarëve të Kuvendit dhe i anëtarëve të organeve të Odës mund të përfundojë para afatit në rast të:
 - 3.1 humbjes së statusit të anëtarit të Odës;
 - 3.2 dorëheqjes;
 - 3.3 shkarkimit.
4. Nëse zgjedhjet nuk mbahen në kohë, anëtarët aktualë të Kuvendit dhe organet e tjera të Odës vazhdojnë funksionin e tyre deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të mandatit.
5. Mënyra e zgjedhjes dhe revokimit përcaktohet me Rregulloren mbi zgjedhjen e organeve të Odës.
6. Kryetari i Odës, Zëvendëskryetarët, anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Sekretari i Përgjithshëm nuk mund të jenë persona të zgjedhur dhe të emëruar në funksione tjera publike dhe politike, përveç profesionale mjekësore dhe në mësimdhënie.
7. Kompensimi material për angazhimin dhe përgjegjësitë që anëtarët e organeve të Odës, përcaktohet me akt të veçantë.

Neni 23 **Kuvendi i Odës**

1. Kuvendi është organi më i lartë i Odës, i cili ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë të parapara me ligj dhe me këtë Statut.
2. Anëtarët e Kuvendit zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në këto njësi zgjedhore:
 - 2.1. Njësia zgjedhore e Prishtinës: Prishtinë, Fushë Kosovë, Podujevë, Lipjan, Obiliq, Gllogoc, Graçanicë;
 - 2.2. Njësia zgjedhore e Prizrenit: Prizren, Suharekë, Malishevë, Dragash, Mamushë;
 - 2.3. Njësia zgjedhore e Pejës: Pejë, Deçan, Klinë, Istog Junik;
 - 2.4. Njësia zgjedhore e Gjakovës: Gjakovë dhe Rahovec;
 - 2.5. Njësia zgjedhore e Gjilanit: Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërdë, Klokot, Partesh, Ranilluk;
 - 2.6. Njësia zgjedhore e Ferizajit: Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpçë, Hani i Elezit;

- 2.7. Njësia zgjedhore e Mitrovicës: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok;
- 2.8. Njësia zgjedhore e Qendrës Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK) me Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale (KKMF).

Neni 24 **Përbërja dhe përfaqësimi në Kuvend**

1. Kuvendi i Odës përbëhet nga 55 (pesëdhjetë e pesë) anëtarë me të drejtë vote.
2. Përbërja e Kuvendit përcaktohet në bazë të delegimit të anëtarëve nga njësitë zgjedhore të përcaktuara në nenin 22, paragrafi 2, si vijon:
 - 2.1 Njësia zgjedhore Prishtinë – 14 (katërmëdhjetë) anëtarë;
 - 2.2 Njësia zgjedhore QKSUK me KKMF - (dhjetë) anëtarë;
 - 2.3 Njësia zgjedhore Prizren – 7 (shtatë) anëtarë;
 - 2.4 Njësia zgjedhore Gjilan – 6 (gjashtë) anëtarë;
 - 2.5 Njësia zgjedhore Pejë – 6 (gjashtë) anëtarë;
 - 2.6 Njësia zgjedhore Gjakovë – 4 (katër) anëtarë;
 - 2.7 Njësia zgjedhore Ferizaj – 4 (katër) anëtarë;
 - 2.8 Njësia zgjedhore Mitrovicë – 4 (katër) anëtarë.
3. Delegimi i anëtarëve nga njësitë zgjedhore bëhet në pajtim me procedurat, kriteret dhe afatet e përcaktuara me Rregulloren Zgjedhore të Odës.

Neni 25 **Kompetencat e Kuvendit**

1. Kuvendi ka këto përgjegjësi dhe autorizime:
 - 1.1. Miraton, ndryshon dhe plotëson Statutin dhe aktet e tjera normative;
 - 1.2. Miraton Kodin e Etikës dhe Deonatologjisë Stomatologjike;
 - 1.3. Miraton programin e punës së Odës;
 - 1.4. Miraton, ndryshon dhe plotëson rregulloren e punës së Odës;
 - 1.5. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin;
 - 1.6. Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues;

- 1.7. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin, Zëvendëskryetarin dhe anëtarët e Këshillit Etik;
- 1.8. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës;
- 1.9. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Gjyqit të Nderit;
- 1.10. Zgjedh dhe shkarkon Prokurorin;
- 1.11. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e komisioneve të përhershme;
- 1.12. Përcakton lartësinë e anëtarësisë;
- 1.13. Përcakton lartësinë e taksave për licencim, rilicencim dhe për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve e dokumenteve të tjera;
- 1.14. Përcakton lartësinë e kompensimit për regjistrim në regjistrin e anëtarëve të Odës;
- 1.15. Vendos për lartësinë e mjeteve të ndara për fondin e Odës për ndihmë reciproke të anëtarëve të Odës;
- 1.16. Shqyrton dhe miraton raportet e punës së organeve të Odës;
- 1.17. Miraton raportin vjetor të Odës;
- 1.18. Miraton raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare të Odës;
- 1.19. Miraton raportin mbi punën e Këshillit Drejtues;
- 1.20. Mund të shpërndajë Kuvendin dhe të shpallë zgjedhje të parakohshme;
- 1.21. Vendos për anëtarësim të Odës në organizatat ndërkombëtare si motra dhe për ndarjen e mirënjohjeve/shpërblimeve;
- 1.22. Shqyrton dhe merr qëndrime parimore për çështjet me rëndësi për punën e Odës.

Neni 26

Mbledhjet dhe vendimarrja

1. Mbledhjet e Kuvendit janë publike, përveç kur shqyrtohen çështjet konfidenciale ose të ndjeshme, me propozim të Kryetarit dhe miratimin paraprak të Këshillit Drejtues mund të jenë të mbyllura.
2. Kuvendi mbahet nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

3. Kuvendi mban së paku një mbledhje gjatë vitit kalendarik.
4. Mbledhjen e udhëheq Kryetari i Odës.
5. Votimi është i hapur përveç në raste kur Kuvendi vendos ndryshe.
6. Statuti i Odës, Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike, miratohen me 2/3 e votave të përgjithshme të anëtarëve të Kuvendit.
7. Vendimet e tjera merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
8. Me Rregulloren mbi Punën e Kuvendit përcaktohen mënyrat e thirrjes, udhëheqjes së mbledhjeve, marrjes së vendimeve dhe çështje të tjera procedurale e teknike.

Neni 27

Mbledhjet e jashtëzakonshme

1. Me propozim të Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës ose të 1/3 së anëtarëve të Kuvendit, Kryetari është i obliguar të thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme në afat prej 15 ditësh nga pranimi i propozimit.
2. Afati për dërgimin e ftesës, rendit të ditës dhe materialit përcjellës është tre (3) ditë para mbajtjes së mbledhjes.
3. Nëse nuk thirret mbledhja sipas paragrafit 1 të këtij neni, propozuesit mund ta thërrasin atë.
4. Propozimi duhet të jetë me shkrim dhe t'i dërgohet zyrës së Kryetarit përmes Sekretarit të Përgjithshëm.
5. Mbledhjen e jashtëzakonshme mund ta thërrasë edhe Kryetari, në pamundësi, njëri nga Zëvendëskryetarët.

Neni 28

Kryetari i Odës

1. Kryetari është anëtar i Kuvendit që e përfaqëson Odën dhe mbron interesat e saj, duke qenë përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë.
2. Mandati i kryetarit zgjat katër (4) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. vetëm edhe njëherë.
3. Procedura dhe mënyra e zgjedhjes rregullohen me Rregulloren për zgjedhjen e organeve të Odës.

4. Mandati mund të përfundojë edhe para kohe në rast:

- 4.1 Humbjeje statusi të anëtarit;
- 4.2 Dorëheqjeje ose shkarkimi.

5. Kuvendi e shkarkon Kryetarin në rast:

- 5.1 kur i është terhequr përkohësisht ose përgjithmonë licenca për ushtrim të pavarur të veprimtarisë;
- 5.2 me vendim gjyqësor të formës së prerë i është hequr ose kufizuar aftësia për veprim; ose
- 5.3 me vendim gjyqësor të formës së prerë është dënuar me burgim efektiv më shumë se gjashtë(6) për vepër penale.

Neni 29

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit

1. Kryetari ushtron detyrat e mëposhtme:

- 1.1. Përfaqëson Odën dhe vepron në emër të saj;
- 1.2. Fton dhe udhëheq seancat e Kuvendit;
- 1.3. Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit;
- 1.4. Ekzekuton aktet e Kuvendit;
- 1.5. I propozon Kuvendit emërimin dhe shkarkimin e zëvendësve të tij.
- 1.6. Organizon punën dhe drejton politikën e Odës;
- 1.7. Propozon akte nënligjore për miratim në Kuvend;
- 1.8. Raporton para Kuvendit për situatën ekonomiko-financiare të Odës, së paku njëherë në vit apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi;
- 1.9. Kryetari vetë ose përmes të autorizuarit, mund të marrë pjesë në punën e të gjitha organeve të Odës.
- 1.10. Në mungesë, Kryetarin e zëvendëson njëri nga Zëvendësrkryetarët;
- 1.11. Kryetari jep informata për publik ose e autorizon një anëtar tjetër;

1.12. Aktivitetet tjera që i caktohen me akte të veçanta.

Neni 30 **Zëvendëskryetarët**

1. Kryetari i propozon Kuvendit emërimin e tre (3) Zëvendëskryetarëve: një nga kujdesi parësor, një nga veprimtaria private dhe një nga stafi akademik.
2. Zëvendëskryetari nga stafi akademik udhëheq edhe Komisionin e përhershëm për specializime dhe nuk është anëtar i Këshilli Drejtues.
3. Zëvendëskryetarët emërohen dhe shkarkohen nga Kuvendi me propozim të Kryetarit.

Neni 31 **Këshilli Drejtues**

1. Këshilli Drejtues (KD) përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë prej të cilëve një (1) nga komuniteti joshumicë dhe një (1) nga komunitetet e tjera.
2. Kryetari dhe dy Zëvendëskryetarët e OSK-së janë anëtarë sipas detyrës zyrtare.
3. Pesë (5) anëtarë i zgjedh Kuvendi nga radhët e veta, ndërsa tre (3) anëtarë i delegon Ministria e Shëndetësisë.
4. Kryesuesi i KD-së zgjidhet nga anëtarët e tij me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.
5. Zëvendëskryesuesi i KD-së propozohet nga Kryesuesi dhe zgjidhet me shumicë votash.
6. Mënyra e punës rregullohet me rregullore pune.
7. Sekretari i Përgjithshëm është person i ftuar gjithmonë në takimet e KD-së.
8. Sekretari i përgjithshëm i OSK-së nuk ka të drejtë vote, por ka të drejtë për të propozuar pika në rendin e ditës dhe dokumentet mbështetëse të tyre.
9. Mandati i anëtarëve të KD-së zgjat katër vjet (4) dhe përputhet me mandatin e Kuvendit.
10. Mbledhjet i udhëheq Kryesuesi, në mungesë Zëvendëskryesuesi.

11. KD vendos me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e kryesuesit është përcaktuese.
12. Rendi i ditës dhe materialiet përgatiten nga Kryesuesi në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm
13. KD mban mbledhje të rregullta së paku një herë në muaj.
14. KD për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Odës.
15. KD i paraqet raport me shkrim Kuvendit për punën e tij së paku dy herë në vit.
16. Kryesuesi i KD-së mund të ftojë në mbledhje udhëheqës të institucioneve ose të shoqatave profesionale për pjesëmarrje aktive por pa të drejtë vote.

Neni 32 **Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues**

1. Këshilli Drejtues:
 - 1.1. Është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Odës;
 - 1.2. Përcakton propozimin e Statutit dhe akteve të tjera të Odës;
 - 1.3. I propozon Kuvendit anëtarët e organeve të Odës;
 - 1.4. Përcjell dhe harmonizon punën e organeve të Odës;
 - 1.5. Përcakton propozimin e programit të punës së Odës;
 - 1.6. I propozon organeve shtetërore masat për mbrojtjen dhe përparimin e mbrojtjes shëndetësore dhe të sigurimit shëndetësor;
 - 1.7. Përcakton planin financiar të Odës dhe kujdeset për zbatim;
 - 1.8. Miraton llogaritë periodike financiare;
 - 1.9. Emëron sekretarin e përgjithshëm me anë të konkursit publik, dhe e shkarkon të njëjtin sipas procedurave të parapara;
 - 1.10. Shqyrton dhe miraton raportet periodike të punës së Odës në fushat për të cilat është përgjegjës;

- 1.11. Miraton rregulloren mbi organizimin dhe sistematizim e punëve të shërbimit profesional të Odës dhe merr masa për sigurimin e ligjshmërisë dhe efikasitetin e punës së shërbimit profesional;
 - 1.12. Vendos në shkallë të dytë sipas ankesave nga marrëdhënia e punës të punëtorëve të shërbimit profesional të Odës; dhe
 - 1.13. Kryen edhe punë tjera të parapara me akte të veçanta.
2. Kompensimi për punën e Këshillit Drejtues rregullohet me akt të veçantë.

Neni 33 **Këshilli Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës:
 - 1.1. Mbikëqyr veprimtarinë financiare të Odës;
 - 1.2. Mbikëqyr realizimin e të drejtave dhe obligimeve të anëtarëve të Odës;
 - 1.3. Mbikëqyr punën e shërbimit profesional të Odës;
 - 1.4. Propozon KD-së marrjen e masave dhe veprimeve në rastet kur vlerëson se ka shkelje ligjore dhe të akteve të miratuar nga Kuvendi;
 - 1.5. Kryen dhe punë tjera të parapara me akte të veçanta.
2. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga shtatë (7) anëtarë: Kryetarin, Zëvkryetarin dhe tre (3) anëtarë tjerë i zgjedh Kuvendi nga radha e anëtarëve të vetë, ndërsa dy (2) anëtarë i delegon Ministria e Shëndetësisë.
3. Këshilli Mbikëqyrës për punën e vet i përgjigjet Kuvendit.

Neni 34 **Këshilli Etik**

1. Këshilli Etik:
 - 1.1 Mbikëqyr zbatimin e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike;

- 1.2 Siguron udhëheqje etiko-morale e deontologjike dhe promovon parimet e etikës profesionale;
 - 1.3 Merr masa në rast të shkeljesh së Kodit Etik dhe të Deontologjisë Stomatologjike;
 - 1.4 Pranon dhe shqyrton ankesat nga ana e qytetarëve;
 - 1.5 Jep mendimet dhe vlerësimet për punën e anëtarëve të Odës në pajtim me Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike;
 - 1.6 U ofron mbështetje qytetarëve në realizimin e së drejtës së cilësisë së shërbimeve, llojit dhe përmbajtjes së tyre;
 - 1.7 Kryen dhe pune tjera të parapara me Statut të Odës, si dhe me akte të veçanta të Odës.
2. Këshilli Etik përbëhet nga pesë (5) anëtarë: Kryetari, Zëvendëskryetari dhe dy anëtarët e tjerë të Këshillit Etik i zgjedh Kuvendi nga radha e anëtarëve, në pajtim me Rregulloren mbi zgjedhjen e organeve të Odës, ndërsa një anëtar e delegon Ministria e Shëndetësisë.

Neni 35 Masat Disiplinore

1. Këshilli Etik, si organ i shkallës së parë, fillon procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë për shkelje të Ligjit, Statutit dhe Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike dhe, varësisht shkeljeve, shqipton këto masa:
 - 1.1. Rekomandim kolegjial;
 - 1.2. Kërkim falje ndaj pacientit;
 - 1.3. Qortim ose qortim publik,
 - 1.4. Arsimit shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnim;
 - 1.5. Trajtimi i detyrueshëm nga alkooli, droga dhe vese të tjera;
 - 1.6. Tërheqja e përkohshme ose e përhershme e licencës dhe/ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri;
 - 1.7. Kompensimin e dëmit të pacientit kur është e përshtatshme;
 - 1.8. Dënimi me të holla prej 1. 000 € deri në 3. 000 € për çdo shkelje të rëndë të ligjit, detyrave profesionale dhe etike.

Neni 36 Afatet dhe procedura para Këshillit Etik

1. Në procedurë para Këshillit Etik zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën administrative në lidhje me thirrjen e palëve, sigurimin e provave, procesverbalin, dëgjimin e palës dhe procedurave tjera.

2. Anëtarit ndaj të cilit është filluar procedura disiplinore duhet t'i mundësohet deklarimi dhe mbrojtja pranë Këshillit Etik.
3. Në procedurën e marrjes në pyetje të anëtarëve dhe vlerësimit të provave në procedurë disiplinore para Këshillit Etik mbahet procesverbali.
4. Procedura pranë Këshillit Etik, nuk mund të fillojë në rast se kanë kaluar më shumë se nëntë (9) muaj nga shkelja e supozuar profesionale e anëtarit. Në këto raste, me vendim refuzues Këshilli Etik mbyll procedurë.
5. Këshilli Etik, brenda 60 ditësh nga pranimi i ankesës, nxjerr vendimin meritor.
6. Ndaj vendimit të Këshillit Etik vendos Gjyqi i Nderit.
7. Gjyqi i Nderit vendos edhe për ankesat e anëtarëve të Odës dhe parregullsitë në procesin e zgjedhjeve.
8. Deri në vërtetësinë e dyshimit të bazuar, anëtari i cili është në procedurë, konsiderohet i pafajshëm dhe i gëzon të gjitha të drejtat.

Neni 37

Afati i inicimit para Gjyqit të Nderit

Fillimi i procedurës para Gjyqit të Nderit për shkeljet sipas nenit 34, paragrafët 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8 nuk mund të ndodhë pas skadimit të një (1) viti nga dita e shkeljes.

Neni 38

Përcaktimi i shkeljeve profesionale

Kriteret për përcaktimin e shkeljeve dhe procedurën për përgjegjësinë e stomatologëve për shkeljet e këtij Statuti dhe Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike përcaktohen me akt të veçantë të Odës.

Neni 39

Gjyqi i Nderit

1. Gjyqi i Nderit është organ i Odës që ushtron funksionet e përcaktuara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, këtë Statut dhe aktet e tjera normative.
2. Gjyqi i Nderit ka pesë (5) anëtarë: Kryetari, zëvendësi i tij dhe dy (2) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi.
3. Një (1) anëtar dhe zëvendësi i tij propozohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Neni 40

Ndaj vendimit përfundimtar me të cilin është shqiptuar masa disiplinore sipas nenit 34, paragrafët 1.4 - 1.8, stomatologët mund të ushtrojnë ankesë në Gjyqin e Nderit.

Neni 41

Gjyqi i Nderit vendos edhe lidhur me ankesat e anëtarëve të Odës dhe parregullësitë në procesin e zgjedhjeve të organeve të Odës.

Neni 42 **Prokurori**

Prokurori është organ i pavarur për iniciimin e procedurës ndaj anëtarëve ndaj të cilëve ekziston dyshimi i bazuar për shkelje të Ligjit, Statutit dhe Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike.

Neni 43

1. Prokurorin edhe zëvendësin e tij e zgjedh Kuvendi nga radha e anëtarëve të Odës, në pajtim me rregulloren mbi zgjedhjen e organeve të Odës.
2. Prokurori i përgjigjet Kuvendit për punën e vet.

Neni 44

Rastet e shkeljes sipas nenit 34 mund t'i denoncojnë: Oda, Ministria e Shëndetësisë, Shoqatat e Profesionistëve Shëndetësorë, Institucionet Shëndetësore, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Prokuroria Shtetërore, anëtarët e Odës dhe pala e dëmtuar.

Neni 45 **Komisionet e përhershme**

1. Anëtarët e komisioneve të përhershme i zgjedh Kuvendi nga radhët e anëtarëve të Odës, në pajtim me Rregulloren mbi zgjedhjen e organeve të Odës.

Neni 46

1. Komisionet e përhershme janë:
 - 1.1. Komisioni për Çështje Etike;
 - 1.2. Komisioni për Licencim;

- 1.3. Komisioni për Edukim Specialistik;
- 1.4. Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional;
- 1.5. Komisioni për Buxhet dhe Financa;
- 1.6. Komisioni i Solidaritetit dhe i Ndhmës Reciproke.

Neni 47

1. Komisionet e përhershme përbëhen nga shtatë (7) anëtarë, nga radhët e të cilëve zgjidhet Kryesuesi dhe Zëvendëskryesuesi.
2. Anëtarët mund të jenë vetëm në një komision të përhershëm.
3. Mbledhjet i thërret dhe i udhëheq Kryesuesi.
4. Komisionet e përhershme i raportojnë për punën e tyre KD, së paku 2 herë në vit. Raportet e shqyrtuara në KD dërgohen në Kuvend për miratim.

Neni 48

Përbërja dhe fushëveprimi i komisionit sipas nenit 45 përcaktohen me akte të veçanta normative.

Neni 49

Kuvendi sipas nevojës mund të formoj edhe komisione tjera të përkohshme dhe me vendim përcakton përbërjen dhe fushëveprimin e tyre.

KREU V FINANCIMI I ODËS

Neni 50

Të hyrat vetanake

1. Oda realizon të hyra vetanake nga:
 - 1.1. Anëtarësia;
 - 1.2. Taksat për licencim dhe rilicencim si dhe taksat për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve të tjera për të cilat mban evidencë zyrtare;
 - 1.3. Dhuratat dhe donacionet e tjera;

- 1.4. Të hyrat nga masat disiplinore dhe
- 1.5. Të hyrat e tjera të përcaktuara me aktet e Odës.

Neni 51

Llogaria dhe përgjegjësia financiare

1. Mjetet derdhen në xhirollogarinë e Odës.
2. Kryetari i Odës është përgjegjës financiar.
3. Oda është përgjegjëse për punën e saj me të gjithë pasurinë që disponon.
4. Menaxhimi financiar rregullohet me akt të veçantë të Kuvendit në përputhje me këtë Statut.

Neni 52

Fondi i solidaritetit dhe i ndihmës reciproke

1. Oda hap llogari të veçantë dhe menaxhon mjetet e dedikuara në fondin e solidaritetit dhe të ndihmës reciproke të anëtarëve.
2. Mjetet përdoren në pajtim me këtë Statut dhe me Rregulloren për solidaritet dhe ndihmë reciproke
3. Fondi i solidaritet përcaktohet sipas kapacitetit financiar të Odës dhe nuk mund të jetë nën shumën prej 3000 euro në vit.

Neni 53

Mjetet nga donacionet dhe dhuratat përdoren në pajtueshmëri me destinacionin; përndryshe, shfrytëzohen në përputhje me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, Statutin e Odës dhe aktet e veçanta për menaxhimin e të hyrave.

KREU VI TRANSPARENCA DHE MBIKËQYRJA

Neni 54 Transparenca

1. Veprimtaria e Odës është publike. Transparenca sigurohet sipas këtij Statuti dhe akteve të përgjithshme të Odës.
2. Me akt të përgjithshëm të miratuar nga Këshilli Drejtues, përcaktohet cilat dokumente e të dhëna përbëjnë sekret afarist, zbulimi i të cilave do të binte ndesh me interesat e Odës dhe të anëtarëve.
3. Oda është e detyruar të njoftojë organet kompetente të ndjekjes, organet gjyqësore dhe Ministrinë e Shëndetësisë për procedure disiplinore ndaj anëtarëve si dhe për procedurat e licencimit, rilicencimit dhe revokimit, kur dyshohet për veprë penale.
4. Me kërkesë të këtyre organeve, Oda u vë në dispozicion faktet dhe informacionet që posedon.

Neni 55

Oda bashkëpunon me institucionet arsimore të profilit shëndetësor, institucionet shëndetësore, shoqatat e profesionistëve shëndetësorë, fondin e sigurimeve shëndetësore, lidhur me çështjet e rëndësishme për punët e Odës dhe të mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve.

Neni 56 Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së Odës në ushtrimin e funksioneve publike sipas nenit 9 të Ligjit mbi Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, e bën Ministria e Shëndetësisë.
2. Në ushtrimin e kësaj mbikëqyrjeje, Ministria e Shëndetësisë mund të kërkojë raporte dhe informata.
3. Oda është e detyruar t'i ofrojë ato brenda 30 ditësh nga dita e kërkesës ose të informojë për arsyet e pamundësisë.
4. Oda është e detyruar që deri më 31 mars të vitit vijues t'i dërgojë Ministrisë së Shëndetësisë raportin vjetor për vitin paraprak.

Neni 57

Oda i nënshtrohet audimit të pavarur të jashtëm së paku një herë në vit.

KREU VII DEKORATAT DHE BOTIMET

Neni 58 Dekoratat

1. Oda mund të ndajë dekorata për anëtarët e nderuar për arritje dhe merita të jashtëzakonshme në zhvillimin e profesionit, si dhe për individë/institucione që kanë dhënë kontribut në fushën e stomatologjisë.
2. Oda do të ketë tre (3) lloje dekoratash:
 - 1.1 Dekorata “Nderi i Stomatologjisë Kosovare”;
 - 1.2 Dekorata për Arritje Shkencore dhe
 - 1.3 Mirënjohja e Odës së Stomatologëve të Kosovës.
3. Kushtet, procedura dhe mënyra e ndarjes përcaktohen me akt të veçantë.

Neni 59 Botimet

1. Oda boton revistën profesionale dhe shkencore “*Revista e Stomatologëve të Kosovës*”, për promovimin dhe përcjelljen e informacionit shkencor e profesional në fushën e stomatologjisë.
2. Gjithashtu, mund të publikojë forma tjera botimesh që janë në intersin e përgjithshëm të anëtarësisë.
3. Kushtet, procedura dhe mënyra e botimeve të Odës përcaktohen me akt normativ të veçantë.

KREU VIII AKTET E PËRGJITHSHME

Neni 60

1. Aktet e përgjithshme të Odës janë Statuti, Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike, rregulloret, udhëzimet dhe vendimet e tjera të organeve të Odës.
2. Aktet duhet të jenë në pajtim me legjislacionin në fuqi, në Republikën e Kosovës.

3. Iniciativën për nxjerrje dhe ndryshimin e akteve të përgjithshme mund ta marrin organet e Odës sipas procedurës së përcaktuar me akt të veçantë.

KREU IX SHËRBIMI PROFESIONAL I ODËS

Neni 61 Veprimtaria e shërbimit profesional

1. Zyra Administrative ushtron:
 - 1.1 detyra administrative dhe profesionale;
 - 1.2 regjistrimin, licencimin dhe autorizimin e profesionistëve shëndetësorë;
 - 1.3 mbajtjen e regjistrit të stomatologëve; aktivitetet e tjera që i delegohen nga Oda; si dhe
 - 1.4 detyrat administrative sipas neneve 9 dhe 10 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë.
2. Këto detyra kryhen në bazë të kontratës për shërbime ndërmjet Odës dhe zyrtarit të Zyrës Administrative.

Neni 62 Organizimi i shërbimit profesional

1. Organizimi dhe puna e Zyrës Administrative përcaktohen me akt të veçantë për organizimin dhe sistematizimin e punëve, të miratuar nga Këshilli Drejtues.
2. Të punësuarit gëzojnë të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me Ligjin e Punës, këtë Statut dhe aktet tjera.
3. Punën e Zyrës Administrative e udhëheq Sekretari i Përgjithshëm i Odës.

KREU X DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 63 Dispozitat kalimtare

1. Organet e krijuara në përbërjen aktuale të Kuvendit vazhdojnë së funksionuari deri në fund të mandatit të rregullt.
2. Brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij Statuti, grupet punuese të emëruara nga Këshilli Drejtues propozojnë harmonizimin e akteve nënligjore të Odës me këtë Statut.

Neni 64
Dispozitat përfundimtare

1. Çështjet procedurale ne zbatim të dispozitave të këtij Statuti, rregullohen me akt të veçantë.
2. Termat dhe procedurat e përcaktuara në këtë Statut për organet e Odës zbatohen, sipas rastit, edhe për organet për të cilat nuk janë rregulluar procedura të veçanta..
3. Zbrazëtirat juridike të cilat mund të krijohen dhe nuk janë të parapara me këtë Statut apo me akte te veçanta, interpretohen nga Këshilli Drejtues në përputhje me rregullimin e odave tjera.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohen dispozitat e akteve juridike të Odës që bien ndesh me të.
5. Ky Statut hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë, ose pas kalimit të afatit për deklarim të Ministrisë.

Kryetari i OSK-së

Ministri i Shëndetësisë

Prishtinë __/__/2025